



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
DREJTORIA E PROGRAMEVE TË ZHVILLIMIT NË FUSHËN E
MINIERAVE DHE INDUSTRIË**

Nr. 8295 / prot.

Tiranë, më 08.4.2018

Lënda: Njoftim për fillim procedurash revokimi të lejes nr. 411, datë 21.05.1998.

SHOQËRISË “SILBORA” SH.P.K

Pika e Shitjes së Materialeve të Ndërtimit, Kryqëzimi i Bathores, Kamëz, Tiranë.

**Për dijëni: AGJENCISË KOMBËTARE TË BURIMEVE NATYRORE
Bulevardi “Bajram Curri”, Blloku “Vasil Shanto”, Tiranë.**

**AUTORITETIT KOMBËTAR PËR SIGURINË DHE
EMERGJENCAT NË MINIERA
Rruga “Lord Bajron”, Laprakë, Tiranë.**

Shoqëria “Silbora” sh.p.k është zotëruese e lejes minerare të shfrytëzimit nr.411, datë 21.05.1998, për mineral kromi, në objektin “Kotecë”, Pukë, Qarku Shkodër.

Nga struktura përgjegjëse e AKBN-së me shkresën nr.5386 prot., datë 06.06.2018, protokolluar në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) me nr.8295 prot., datë 06.06.2018, është propozuar revokimi i lejes minerare të nr.411, datë 21.05.1998, për mineral kromi, në objektin “Kotecë”, Pukë, Qarku Shkodër, për arsye se ka kaluar afati i vlefshmërisë së lejes i cili ka përfunduar periudhën 20 vjeçare më datë 21.06.2018.

Kjo leje është dhënë në përputhje me Ligjin nr.7796, datë 17.02.1994, “Minerar të Shqipërisë”, të ndryshuar, që është shfuqizuar me Ligjin nr.10304, datë 15.07.2010, “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

Sipas nenit 57, pika 2 dhe 3 të Ligjit nr.10304, datë 15.07.2010, “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, përcaktohet shtrirja e efekteve edhe për lejet e dhëna përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Kështu në zbatim të pikës nr.1, të nenit 16, të Ligjit nr.10304, datë 15.07.2010, “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, për lejen nr.411, datë 21.05.1998, duhet të kishit aplikuar, për zgjatjen e afatit, para datës 21.05.2017, një vit përpara përfundimit të afatit fillestar, të cilën ju nuk e keni bërë.

Propozimi i Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore për revokim, është i mbështetur në germën “ç”, të pikës 1, të nenit 47, (neni që përcakton shkeljet ligjore për

të cilat një leje revokohet) të Ligjit nr.10304, datë 15.07.2010, “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, ku thuhet:

“Zotëruesi i lejes minerare, brenda 30 ditëve kalendarike nga data e çdo viti në vazhdim, që i korrespondon datës së hyrjes në fuqi të lejes, nuk paraqet dokumentin e garancisë financiare të zbatimit të planit të rehabilitimit, dokumentin e garancisë financiare të zbatimit të programit minimal të punës, dokumentin e garancisë financiare të zbatimit të investimit”.

Duke qenë se afati i vlefshmërisë së lejes në fjalë, ka përfunduar, nga ana e shoqërisë tuaj nuk mund të bëhet asnjë veprim, nga ato që përmenden në germëm “ç”, që cituam më lart.

Sa më sipër, në zbatim të nenit 48, të Ligjit nr.10304, datë 15.07.2010, “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, **ju njoftojmë fillimin e procedurave të revokimit të lejes minerare të shfrytëzimit nr.411, datë 21.05.1998, për mineral kromi, në objektin “Kotecë”, Pukë, Qarku Shkodër, që shoqëria juaj zotëron.**

Ju bëjmë me dije se, pas një periudhe 30 ditore nga ky njoftim, do të merret vendimi për revokimin e lejes nr.411, datë 21.06.1998, për mineral kromi, në objektin “Kotecë”, Pukë, Qarku Shkodër.

Në zbatim të nenit 49, të Ligjit nr.10304, datë 15.07.2010, “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, duhet të rehabilitoni zonën e shfrytëzimit në të cilën keni ushtruar aktivitetet minerar.

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin.

MINISTRI

DAMIAN GJIKNURI

ME AUTORIZIM

ZËVENDËSMINISTRI

ENIS ALIKO

